



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE RINISË

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE RINISË STREHIMIT DHE SHËNDETIT
PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë se, Drejtoria e Shërbimit Social, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe administrative ofron shërbime për të gjithë komunitetin dhe në veçanti për kategoritë në nevojë.

Një ndër këto kategori janë edhe të miturit në kontakt ose konflikt me ligjin.

Vënia në zbatim e një sistemi të koordinuar dhe efektiv të drejtësisë miqësore ndaj fëmijës është një element themelor, ku fëmijët janë ndër kategoritë më të rrezikuara dhe më të prekura. Kuadri ligjor i drejtësisë për të mitur, veçanërisht Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Strategjia Kombëtare për Drejtësinë për të Mitur, kërkon një bashkëpunim ndërsektoral ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe pjesëmarrëse në administrimin e drejtësinë penale për të mitur

Në këtë kuadër, Ministria e Drejtësisë dhe Bashkia Shkodër, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi *‘Për sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e kuadrit normativ të drejtësisë për të mitur, veçanërisht të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale për të miturin në konflikt me ligjin.*

Në përgjigje të pyetjeve tuaja sqarojme se, dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin është në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Ambientet e QKPF (Qëndrave Komunitare për Familjen) shërbejnë për shërbime mbështetëse dhe integruese për të gjithë kategoritë, familjet në përgjithësi që kanë nevojë dhe veçanërisht për fëmijët me probleme sociale.

Gjate viteve 2021-2022 kemi trajtuar 33 raste që është bërë vlerësim për të mitur të Bashkisë Shkodër që janë në konflikt me ligjin, me kërkesë të Shërbimit të Provës.

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar 15 raste të miturish në konflikt/kontakt me ligjin.

Ndërsa gjatë vitit 2024 kemi pasur 48 raste të miturish që është dashur të bëhet vlerësim social-ekonomik me kërkesë të Shërbimit të Provës.

Bashkia Shkodër ka funksionale 13 QKPF nga të cilat 8 (tetë) ndodhen në qytetin e Shkodrës dhe 5 (pesë) në Njësitë Administrative.

Nga Qendrat e ngritura në qytet 5 (pesë) janë në çdo lagje të qytetit, ndërsa 2(dy) janë qendra multifunksionale, 1 (një) është Qendër rinore quhet Atelie, ndërsa 1 (një) qëndër për fëmijët me

spektër autik që quhet Harmonia.

Në Njësitë Administrative Qëndrat Komunitare janë Qendrat komunitare në Dajç, Gur i Zi , Rrethina, Postrinë.

Të gjitha QKPF ofrojnë shërbime për komunitetin , për familjet në përgjithësi dhe për fëmijët në veçanti ku hyjnë edhe fëmijët në kontakt ose konflikt me ligjin .

Sipas problematikës që rastet paraqesin bëhet plani i ndërhyrjes.

Bashkia ka planifikuar dhe realizuar çdo vit fond për mbirëmbajtjen dhe përshtatjen e QKPF për shërbimet që ofrojnë.

Vlerat e planifikuar dhe të realizuara janë në 000/lek

Në vitin 2018 jane realizuar 2.454

Ne vitin 2019 jane realizuar 1.841

Ne vitin 2020 jane realizuar 1.319

Ne vitin 2021 jane realizuar 1.379

Ne vitin 2022 jane realizuar 2.296

Ne vitin 2023 jane realizuar 2.830

Ne vitin 2024 planifikuar 2.700

Në QKPF ofrohen shërbime si : orientim, referim, informim, sensibilizim, mbështetje pas shkollore, mbështetje ekonomike për fuqizimin e famijes. Në Qëndren rinore Atelie ofrohen kurse dhe aktivitete te shumëllojshme.

Specialistet e QKPF janë me formim punonjës social ose psikolog dhe kanë marrë trajnime për trajtimin e të miturve dhe mbrojtjen e tyre. Specialistet e QKPF kryejnë funksionin edhe të PMF-së.

Gjatë vitit 2024 kemi pasur 4 raste të mitur të cilët pas dënimit kanë pasur programe integruese dhe përfshirëse në kurse profesionale dhe arsim të mesëm.

Gjatë viteve ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin e Proves dhe Qendrën për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, si dhe me të gjithë institucionet si Drejtoria e Policisë, Prokuroria e Shkodrës, AKPA, Formimin Profesional , Zyra Vendore Arsimore etj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Benet Beci